

**Pyetjet më të shpeshta rreth
Fair Fares NYC dhe Access-A-Ride
(Albanian)**

- 1. Unë jam klient i MTA Access-A-Ride (AAR). Si mund të regjistrohem për Fair Fares NYC (FFNYC) dhe të marr një zbritje për udhëtimet AAR?**

Shkoni te www.nyc.gov/fairfares për të parë nëse kualifikoheni për FFNYC. Nëse kualifikoheni, mund të aplikoni për FFNYC duke dhënë numrin tuaj të ID-së së AAR-së. Nëse MTA-ja konfirmon ID-në tuaj të AAR-së dhe ajo miratohet për ju, do të merrni një zbritje prej 50% për çdo udhëtim AAR.

- 2. Jam klient i AAR-së dhe jam tashmë i regjistruar në FFNYC. Si mund të regjistrohem për të filluar përdorimin e zbritjes së FFNYC NYC në AAR?**

Identifikohuni në llogarinë tuaj në www.nyc.gov/accessfairfares dhe klikoni "Update Access-A-Ride Information (Përditëso informacionin e Access-A-Ride)". Ndiqni udhëzimet në ekran për të zbatuar zbritjen e FFNYC-së në AAR-në tuaj.

Automjetet e Access-A-Ride nuk do të pranojnë MetroCard të Fair Fares NYC. Duhet të përditësoni llogarinë tuaj për të marrë zbritjen.

- 3. Kur do të filloj të marr zbritjen time të FFNYC-së në udhëtimet AAR?**

Do të filloni të merrni zbritjen e FFNYC-së në udhëtimet AAR pasi FFNYC-ja t'ju miratojë dhe MTA-ja të ketë konfirmuar informacionin tuaj të AAR-së.

Mund të identifikoheni në llogarinë tuaj te www.nyc.gov/accessfairfares për të kontrolluar statusin e zbritjes suaj në AAR. Zbritja juaj në AAR do të fillojë deri në një javë pas regjistrimit.

- 4. Si ta përdor zbritjen time të FFNYC-së në AAR?**

Pasi zbritja juaj e FFNYC-së të shtohet në llogarinë e AAR-së, zbritja do të zbatohet automatikisht. AAR-ja do t'ju tarifojë vetëm gjysmën e tarifës.

- 5. Çfarë do t'i ndodhë zbritjes sime të FFNYC-së për metrot dhe autobusët?**

Pasi zbritja juaj e FFNYC-së të jetë zbatuar për AAR-në tuaj, zbritja e FFNYC-së për metrot dhe autobusët do të ndërpritet. Mund të përdorni zbritjen përmes programit të MTA-së me tarifë të reduktuar në metro dhe autobusë.

6. A do të më japë FF NYC-ja një kartë OMNY për të paguar për udhëtimet e transportit individual (komunitar)?

Jo. AAR-ja do t'ju japë një kartë OMNY nëse jeni regjistruar në programin e AAR-së.

7. Çfarë ndodh nëse regjistrimi im në FFNYC përfundon?

FFNYC-ja do t'ju dërgojë njoftim nëse regjistrimi juaj është duke përfunduar. Në njoftim do t'ju tregohet arsyeja dhe data kur do të përfundojë regjistrimi juaj. Pasi të përfundojë regjistrimi juaj, do të jeni përgjegjës për tarifën e plotë kur përdorni AAR-në. Mund të aplikoni përsëri për FFNYC nëse ndryshon situata dhe mund të kualifikoheni sërish.

8. Çfarë do të ndodhë nëse regjistrimi im në AAR përfundon?

Nëse regjistrimi juaj në AAR përfundon, na njoftoni duke u identifikuar në llogarinë në www.nyc.gov/accessfairfares dhe duke klikuar "Update Access-A-Ride Information (Përditëso informacionin e Access-A-Ride)".

Mund të kërkonte një zbritje të FFNYC-së për metrotë dhe autobusët nëse nuk keni një zbritje tjetër transporti. Nëse kualifikoheni për programin e MTA-së me tarifë të reduktuar, duhet të regjistroheni në të për të marrë zbritje për metrotë dhe autobusët.

9. Ku duhet të drejtohem për informacione të mëtejshme për FFNYC-në?

Telefononi në numrin **311** nëse keni pyetje rreth FFNYC-së. Mund të vizitoni gjithashtu www.nyc.gov/fairfares për informacione të mëtejshme.

10. Po nëse më duhet ndihmë për të aplikuar për FFNYC për shkak të një aftësie të kufizuar?

Telefononi **311** nëse ju duhet ndihmë për të plotësuar aplikimin tuaj për FFNYC ose për të dorëzuar dokumentet tuaja për shkak të një aftësie të kufizuar.

**Telefononi 311 nëse keni ndonjë pyetje për programin Fair Fares NYC.
Ju gjithashtu mund të vizitoni nyc.gov/fairfares për informacione të mëtejshme
rreth programit Fair Fares NYC.**